

## Formular për SYLLABUS- Kirurgjia Veterinare I (sem VII)

<b>Të dhëna bazike të lëndës</b>	
<b>Njësia akademike:</b>	Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë
<b>Titulli i lëndës:</b>	<b>Kirurgji Veterinare I</b>
<b>Niveli:</b>	Mjekësi Veterinare
<b>Statusi lëndës:</b>	<b>Obligative</b>
<b>Viti i studimeve:</b>	<b>Viti IV, sem VII</b>
<b>Numri i orëve në javë:</b>	<b>3+2(45/30)</b>
<b>Vlera në kredi – ECTS:</b>	<b>6</b>
<b>Koha / lokacioni:</b>	Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë
<b>Mësimdhënësi i lëndës:</b>	<b>Prof. Dr. Avni Robaj</b>
<b>Detajet kontaktuese:</b>	Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë e-mail: <a href="mailto:avni.robaj@uni-pr.edu">avni.robaj@uni-pr.edu</a> tel: +383 44 141 925
<b>Përshkrimi i lëndës</b>	<p><b>Kirurgji Veterinare I</b> i studion njohurite mbi anestezinë dhe reanimacionin. Klasifikimi anestesizë. Kontrolli klinik dhe klasifikimi i pacientit ne vartësi nga statusi klinik. Zgjedhja e protokollit anestezik dhe parapërgatitja e pacientit për anestezi.</p> <p>Roli dhe indikimet e preanestesizë. Lëndët preanestezike: parasimpatikët, trunkuilizantët, sedativët, analgjezikët, miorelaksantët. Neuroleptanalgjezia dhe kombinimet preanestezike. Indikimet, lëndët anestezike dhe klasifikimi i anestezisë lokale. Anestezia sipërfaqësore, infiltrative, vaskulare, trunkulare e spinale. Teknika e anestezisë trunkulare e spinale në njethundrakë, ripërtypës dhe kafshë të vogla. Llojet e anestezisë së përgjithëshme, indikimet e kundërindikimet. Fazat e rrjedhjes së narkozes. Anestezia parenterale. Anestezia inhalatore, llojet,substancat dhe teknika e anestezisë inhalatore. Anestezia e përgjithëshme në njethundrakë, qen, macë, ripërtypës dhe derra. Anestezia në pacientët me shkallë të lartë rreziku. Anestezia në ndërhyrjet obstetrikale. Anestezia në kafshët e laboratorit, kafshët e egra dhe shpendë. Monitorimi i pacientit gjatë narkozës e zgjimit. Ndërlikimet gjatë anestezisë dhe masat për zgjidhjen e situatave të emergjencës. Eutanazia në llojet e ndryshme të</p>

	<p>kafshëve . Objekti i kirurgjise Veterinare. Lidhja e kirurgjise me disiplinat e tjera. Historiku i zhvillimit te kirurgjise veterinare. Koncepti mbi traumen. Shock-u traumatik. Kontrolli klinik dhe trajtimi i pacientit te traumatizuar. Demtimet e mbyllura te indeve. Hematoma dhe limfoekstravazati, etiopatogeneza, klinika, mjekimi. Plaget dhe llojet e tyre. Veçorite klinike te plageve. Llojet dhe fazat e sherimit te plages. Patologjite e cikratizimit te plages. Mjekimi i plages ne vartesi nga lloji dhe faza e sherimit. Shkaqet qe vonojne sherimin e plageve. Traumat termike. Njohuri mbi infeksionin kirurgjik, lokal dhe te pergjitheshem. Infeksioni kirurgjik i lokalizuar: Forunkuli, abscesi, flegmona, empiema, ulçera dhe fistula. Infeksioni kirurgjik i pergjitheshem: piemia, septicemia. Demtimet traumatike te eneve gjakore. Demtimet traumatike te nervave. Demtimet traumatike te muskujve, tendineve, bursave, tendovaginave. Kontuzionet, plaget, mbitendosjet, çvendosjet dhe keputjet. Demtimet e indeve te forta. Fisurat, frakturat. Periostiti, osteiti, osteomieliti. Plaget, kontuzionet, perdredhjet e çvendosjet e kyçeve. Poçeset inflamative dhe degjenerative. Artrit, artrozat, ankilozat. Njohuri mbi herniet, elementet dhe klasifikimi i hernieve.</p>
<p><b>Qëllimet e lëndës:</b></p>	<p>Kirurgjia Veterinare do te jape njohuri teoriko – praktike mbi patologjite e pergjitheshme kirurgjikale. Semundjet kirurgjikale specifike per organe e rajone te veçanta ne lloje te ndryshme te kafsheve. Klasifikimi anestesise. Kontrolli klinik dhe klasifikimi i pacientit ne vartesi nga statusi klinik. Zgjedhja e protokollit anestezik dhe parapërgatitja e pacientit për anestezi. Roli dhe indikimet e preanestesise. Lëndët preanestezike: parasimpatikët, trunkuilizantët, sedativët, analgjezikët, miorelaksantët. Neuroleptanalgjezia dhe kombinimet preanestezike. Indikimet, lëndët anestezike dhe klasifikimi i anestezisë lokale.</p> <p>Pjesa praktike e programit (kursi i operacioneve), perfshin temat kryesore te nevojshme per aftesimin e pergjithshem praktik te studenteve ne disiplinen e kirurgjise. Ne kete program jane parashikuar ushtrime qe do te realizohen kryesisht ne kafshe te ngordhura si element i ri qe ben te mundur aktivizimin e te gjithe studenteve. Demonstrimi i</p>

	semundjeve kirurgjikale dhe aftesimi ne kryerjen e anesteziave dhe operacioneve te veçanta , do te behet ne oret e demonstrimeve klinike neper klinikat per semundjet e specieve te veçanta.
<b>Rezultatet e pritura të nxënies:</b>	Studentët pas mbarimit të kësaj lënde do të jenë në gjendje përmes ligjëratave dhe ushtrimeve praktike të dijnë dhe të kenë njohuri sa i përket anesteziave lokale, të përgjithshme dhe inhalatore, si dhe operacioneve të të gjitha rajoneve, injeksioneve të ndryshme dhe të kenë njohuri baze sa i përket lëndës së Kirurgjisë.

**Kontributi në ngarkesën e studentit ( gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënës të studentit)**

<b>Aktiviteti</b>	<b>Orë</b>	<b>Ditë/ Javë</b>	<b>Gjithsej</b>
Ligjëratat	3	15	45
Ushtrime (pune praktike, seminare, ushtrime, etj)	2	15	30
Kontakte me mësuesin/konsultime	1	5	5
Detyra të shtëpisë			
Projekte, prezantime, etj.	1	4	4
Koha e studimit vetanë	1	15	15
Përgatitja përfundimtare për provim	3	15	45
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuize, provim final)	1	2	2
Kolokiume	2	2	4
<b>Totali</b>			150

<b>Metodologjia e mësimit:</b>	Leksione , seminare dhe praktika Mjetet: Powerpoint , videokaseta, demonstrim klinik, etj
--------------------------------	--

<b>Metodat e vlerësimit:</b>	15% kolokiumi i parë me shkrim gjatë ligjëratave, 15% kolokiumi i dytë me shkrim gjatë ligjëratave, 10% vlerësim i vijueshmërisë në fund të kursit. 60% provimi final.
------------------------------	---

<b>Literatura</b>	
<b>Literatura bazë:</b>	Veterinary Anaesthesia, Eleventh Edition, K. W. Clarke, C. M. Trim, L. W. Hall, 2014  Amanda M. Shelby, Carolyn M. Mc Kune- Small Animal Anesthesia Techniques. This edition first

published 2014 © 2014 by John Wiley & Sons, Inc.

Anesthesia and Pain Management in Dogs and Cats- Jeff C Ko DVM, MS, Dip ACVA, Professor of Anesthesiology, Department of Veterinary Clinical Sciences, College of Veterinary Medicine, Purdue University, West Lafayette, Indiana, USA, 2013

Slatter, D. H.: Textbook of small animal surgery. Philadelphia: Saunders, 2003.

Hall, L.W., Clarke, K.W. & Trim, C.M. (2001) *Veterinary Anaesthesia* 10<sup>th</sup> edition. WB Saunders, London.

Adetunji A, Adewoye CO, Ajadi RA. Comparison of epidural anaesthesia with lignocaine or xylazine in cats. *Vet J.* 2002

Bedford, P.G.C.: Small Animal Anesthesia. The Increased-Risk Patient. Bailliere Tindall, 1991.

Hall, L.W. - Clarke, K. N.: Veterinary anaesthesiology. London, Bailliere Tindall, 1992.

Melwraith, C. W. - Turner, A. S.: Equine surgery advance techniques. Philadelphia, Lea & Febiger, 1987.

Muir W. W. Hubbel, J. A. E.: Handbook of Veterinary Anesthesia. Mosby, 1995

Paskal Gjino.: Kirurgjia Veterinare, Tirane 2007

Dražen Matičić i Dražen Vnuk - Veterinarska kirurgija i anesteziologija-, Zagreb 2010.

Brinker, N. O. - Piermattei, D. L. - Flo, G. L.: Handbook of small animal orthopedics and fracture treatment. Philadelphia, Saunders, 1990.

Permattei, D. L.: An atlas of surgical approaches the bones and joints of the dog and cat. Philadelphia, Saunders, 1993.

Stashak, T. S.: Equine wound management. Philadelphia, Lea & Febiger, 1991.

Traub-Dargatz, J. L - Brown, C. M.: Equine endoscopy. St. Louis, Mosby, 1990.

Cheli R., Clinica Chirurgica Veterinaria, UTET terza edizione, Torino 1988.

<b>Literatura shtesë:</b>	Paskal Gjino.: Kirurgjia Veterinare, Tirane 2007  Dražen Matičić i Dražen Vnuk - Veterinarska kirurgjia i anesteziologija-, Zagreb 2010.
<b>Plani i dizajnuar i mësimit:</b>	
<b>Java</b>	<b>Ligjerata që do të zhvillohet</b>
<i>Java e parë:</i>	Njohuri mbi anestezinë dhe reanimacionin. Rëndësia e anesteziologjisë në mjekësinë Veterinare. Klasifikimi anestezië. Kontrolli klinik dhe klasifikimi i pacientit në vartësi nga statusi klinik. Zgjedhja e protokollit anestezië dhe parapërgatitja e pacientit për anestezië.
<i>Java e dytë:</i>	Roli dhe indikimët e preanestezië . Lëndët preanestezië: parasimpatikët, trankuilizantët, Sedativët, analgjezikët, miorelaksantët. Neuroleptanalgjezia dhe kombinimet preanestezië. Indikimët, lëndët anestezië dhe klasifikimi i anestezië lokale. Anestezia sipërfaqësore, infiltrative, vaskulare, trunkulare e spinale. Teknika e anestezië trunkulare e spinale ne njëthundrakë, ripertypes dhe kafshë të vogla.
<i>Java e tretë:</i>	Llojet e anestezië së përgjithëshme, indikimët e kundërindikimet. Fazat e rrjedhjës së narkozës. Anestezia parenterale me barbiturate, kloralhydrat, anestezia disociative dhe anestezia e kombinuar .Anestezia inhalatore, llojet, substancat dhe teknika e anestezië inhalatore. Anestezia e përgjithëshme në njëthundrakë, qen, mace, ripertypes e derra.
<i>Java e katërt:</i>	Anestezia në pacientët me shkallë të lartë rreziku. Anestezia në ndërhyrjet obstetrikale ( Kafshet barëse dhe në pjellje ). Anestezia në kafshët e laboratorit, kafshët e egra dhe shpendë.
<i>Java e pestë:</i>	Monitorimi i pacientit gjatë narkozës dhe zgjimit.Ndërlikimet gjatë anestezië dhe masat për zgjidhjen e situatave të emergjences.Eutanazia në llojët e ndryshme të kafshëve.
<i>Java e gjashtë:</i>	Kolokium
<i>Java e shtatë:</i>	Objekti i kirurgjisë Veterinare. Lidhja e kirurgjisë me disiplinat e tjera. Historiku i zhvillimit te kirurgjisë veterinare. Koncepti mbi traumen. Llojet e traumave . Ndikimi i traumës ne organizmin e kafshes dhe reagimi i organizmit ndaj traumas. Shock- u traumatik, fiziopatologjia, klinika, mjekimi. Kontrolli klinik dhe trajtimi i paciantit te traumatizuar.
<i>Java e tetë:</i>	Kompresioni , kontuzioni, keputja, etiopatogeneza, klinika, mjekimi. Hematoma e limfoekstravazati , etiopatogeneza,

	klinika, mjekimi.
<i>Java e nëntë:</i>	Plaget, shenjat (forma , hemoragjia, dhimbja) dhe llojet e plageve, veçorite klinike te plageve te llojeve te ndryshme. Llojet dhe fazat e sherimit te plages. Patologjite e cikratizimit te plages.
<i>Java e dhjetë:</i>	Mjekimi i plages ne vartesi nga lloji dhe faza e sherimit. Shkaqet qe vonojne sherimin e plageve. Djegjet termike: shkaqet , shkallet, ndryshimet lokale e te pergjitheshme, klinika, mjekimi. Ngrirjet : shkaqet , shenjat, mjekimi. Djegjet kimike, shkaqet, shenjat klinike , mjekimi.
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Njohuri mbi infeksionin kirurgjik, lokal dhe te pergjitheshem, shkaqet dhe faktoret qe ndikojne ne lindjen e infeksionit. Infeksioni kirurgjik i lokalizuar: Forunkuli, abcesi, flegmona, empiema, ulçera dhe fistula. Infeksioni kirurgjik i pergjitheshem: piemia, septicemia. Patologjitë kirurgjikale të enëve gjakore dhe nervave.
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Poçeset inflamative dhe degjenerative. Artritit, artrozat, ankilozat.
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Demtimit traumatike te muskujve e tendineve, kontuzionet, plaget, mbitendosjet, çvendosjet dhe keputjet. Inflamacioni i muskujve dhe tendineve ( Miozitet dhe tendinitet).
<i>Java e katërbëdhjetë:</i>	Njohuri mbi herniet, elementet dhe klasifikimi i hernieve.
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Kolokium
<b>Java</b>	<b>Ushtrimet që do të zhvillohen</b>
<i>Java e parë:</i>	Teknika e anestezisë lokale. Anestezia sipërfaqësore
<i>Java e dytë:</i>	Anestezia infiltrative. Anestezia trunkulare. Anestezia epidurale.
<i>Java e tretë:</i>	Anestezia e përgjithshme në kafshë të ndryshme
<i>Java e katërt:</i>	Anestezia e përgjithshme në kafshë të ndryshme
<i>Java e pestë:</i>	Anestezia e përgjithshme në kafshë të ndryshme
<i>Java e gjashtë:</i>	Demonstrim i anestezisë së kalit
<i>Java e shtatë:</i>	Kolokium
<i>Java e tetë:</i>	Diagnostikimi i qalimeve ne kafshet e vogla.
<i>Java e nëntë:</i>	Ekzaminimi neurologjik në kafshë të vogla
<i>Java e dhjetë:</i>	Plaget, bandazhimi ne kafshet e vogla. Ekzaminimi emergjent ne kafshet e vogla.
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Kirurgjia operative I. (përgatitja plagës, materialet e qepjes, mbyllja e plagës, llojet e qepjes)
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Kirurgjia operative II. (përgatitja plagës, materialet e qepjes, mbyllja e plagës, llojet e qepjes)
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Kirurgjia operative III. (përgatitja plagës, materialet e qepjes, mbyllja e plagës, llojet e qepjes)
<i>Java e katërbëdhjetë:</i>	Kolikrat, diagnostikimi i tyre
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Kolokium

**Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:**

*Cakto politikat e mirësjelljes konfor statusit të UP-së.*

Mbajtja e plan programit të prezentuar në sylabus, prezentimi i informacioneve shtesë, trajtimi i tematikava aktuale dhe emergjente.